

NJOFTIM PËR SHTYP

MBI MBLEDHJEN E KOMISIONIT TË SHOQËRISË CIVILE PËR VERIFIKIMIN PARAPRAK TË KANDIDATURAVE PËR ANËTARIN QË PËRFAQËSON SHOQËRINË CIVILE NË KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR DHE KËSHILLIN E LARTË TË PROKURORISË

Më datë 26 shtator 2023, ora 09.30, në ambjentet e institucionit të Avokatit të Popullit u zhvillua mbledhja e Komisionit të Shoqërisë Civile, i cili do të kryejë verifikimin paraprak të kandidatave për anëtarin që përfaqëson shoqërinë civile në KLGJ dhe KLP.

Prezent në këtë mbledhje ishin përfaqësuesit e organizatave të mëposhtme:

- ✓ Qendra “Qëndresa Qytetare”
- ✓ Fondacioni “Kontribut për Edukim”
- ✓ Qendra Shqiptare për një Zhvillim të Qëndrueshëm
- ✓ Shoqata “Drejtësia Sociale”
- ✓ Klinika Ligjore “Wisdom”

Qëllimi i këtij takimi ishte hartimi i rregullores së funksionimit të komisionit të shoqërisë civile, ku pati diskutime mes anëtarëve për mënyrën e vlerësimit nëpërmjet pikëzimit të kandidatave.

Komisioni vendosi për t’i dhënë kohë të mjaftueshme anëtarëve për të dhënë sugjerime dhe vlerësime mbi draft – rregulloren e propozuar e cila pritet të miratohet në mbledhjen e radhës.

Në këtë mbledhje ishin prezent dhe vëzhgues të organizatave dhe institucioneve ndërkombëtare të:

- ✓ OPDAT
- ✓ EU FOR JUSTICE
- ✓ OSCE
- ✓ KOMITETI SHQIPTAR I HELSINKIT

Komisioni i shoqërisë civile vendosi që mbledhja e radhës të zhvillohet ditën e hënë, më datë 2 tetor 2023, ora 09.30, pranë ambjenteve të institucionit të Avokatit të Popullit.